



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALESI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 1553/Prot.  
2

Koplik, më 03.06.2021

V E N D I M

Nr. 31 Datë 28 / 05 / 2021

**“PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TË PAGËS SË 2 POZICIONEVE TË STRUKTURËS ADMINISTRATIVE SË BASHKISË MALËSISË SË MADHE”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, germa ç, të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor të Rsh-se”, Ligj Nr. 137/2020 “Për Buxhetin e Vitit 2021”, dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.1 datë 11.01.2021 si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe nr. 205, datë 30.12.2020 ‘Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë për vitin 2021 të Bashkisë Malësi e Madhe, Njësive Administrative dhe Funksioneve të Deleguara’, VKM nr.177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.165, datë 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Per grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarve të zgjedhur e të emeruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”,

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e nivelit të pagës së pozicioneve të miratuara me Strukturën Administrative të Bashkisë Malësisë së Madhe si më poshtë :

Infermier – me pagë pozicioni 34.500 lekë.

Fizioterapist - me pagë pozicioni 34.500 lekë.

Të dy pozicionet janë trajtuar me VKM nr. 717 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” sipas Lidhjes nr.1/6.

2. Pozicionet e Infermier dhe Fizioterapist , pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, pjesë e Bashkisë Malësisë së Madhe ndryshon si më poshtë :

Infermier – me pagë pozicioni 33.500lekë.

Fizioterapist - me pagë pozicioni 33.500lekë.

Këto dy pozicione do të trajtohen me VKM nr.177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.165 datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave , “Per grupimin e njësive të veteqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarve të zgjedhur e të emeruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të veteqeverisjes vendore” sipas Lidhja nr.4 , Klasa III, Kategoria III-b.

Infermier – me pagë pozicioni 34.500 lekë.

Fizioterapist - me pagë pozicioni 34.500 lekë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”,

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miraturar me 28.05.2021

Vota Pro 20

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 31.05.2021

